

Të nderuar,

Kjo intervistë bëhet në kuadër të punimit tim të masterit në Programin e Magjistraturës në lëminë e Diplomacisë në Universitetin e Evropës Juglindore, në temë “Roli i OJQve, shoqërisë civile dhe lëvizjeve sociale në tranzicionin demokratik në Maqedoni nga pavarësia në 1991”. Përgjigjet tuaja do më ndihmojnë në hulumtimin tim, dhe të njëjtat do jenë anonime. Ju faleminderit paraprakisht për kohën tuaj!

Me nderime,

Lejla Alili

1. Sa mendoni se Organizatat Joqeveritare dhe lëvizjet sociale kanë luajtur rol në demokratizimin e institucioneve të vendit, si dhe shoqërisë në përgjithësi, që nga pavarësia e deri më sot?

OJQ-të mendoj se janë përpjekur që të japin kontributin e tyre për përmirësimin e jetës sociale nëpërgjithësi në Maqedoni. Mbase sukses kanë arritur në fillimin e punës, mirëpo më vonë gati se kanë harruar objektivin se për çfarë janë themeluar. Të jemë më i qartë, si duket gjatë kohës në vend që shoqatat të ndihojnë në demokratizimin dhe lëvizjet sociale ato kanë rënë në duar të bandave të pushtetit dhe kështu janë vënë në shërbim aluziv ndaj personave të caktuar.

Mendoj që OJQ-të nuk kanë dhënë ndonjë kontribut të theksuar në demokratizimin e shoqërisë në Maqedoni meqë fatkeqësisht OJQ-të për mendimin tim janë të themeluara dhe të ndara në baza etnike dhe të interesave të ngushta.

2. A konsideroni se organizatat joqeveritare dhe lëvizjet qytetare kanë qenë faktor relevant në vitet e fundit (2010-2017)?

OJQ-të e mbikqyrura nga jashtë mbase kanë qenë faktor për zgjidhjen e ndonjë çështjeje të rëndësishme, ndërkaq shoqatat e vendit kanë qenë dhe ngelin të anatemuara apo le të themi se janë të dirigjuara dhe nuk mund të veprojnë lirshëm.

3. Sipas jush, a ka transparencë të duhur në procesin e punës së organizatave joqeveritare në Maqedoni?

OJQ-të në Maqedoni mendoj se kanë autokraci dhe u mungon transparenca. Pse ata e dine!!!???

4. A u besojnë qytetarët organizatave joqeveritare dhe lëvizjeve qytetare? PSE?

Në mjediset ku kam punuar dhe ku jetoj qytetarët gati aspak nuk ju besojnë shoqatave.

Kjo meqë pjesa dërmuese e qytetarëve mendojnë se shoqatat janë në shërbim të dikujt dhe punojnë nën direktiva të tjerëve. Bile, mbase edhe janë themeluar për objektiva të caktuara dhe pasi arrijnë t'i përmbushin qëllimet shumë thjeshtë "zhduken". Raste të këtilla janë të shumta sidomos këtë e hasim te shoqatat "bëmirse".

5. Sa u lejohet organizatave joqeveritare të jenë pjesë e procesit të vendimmarrjes në vend?

Mendoj që OJQ-të formalisht konsultohen por në thelb nuk merren parasysh sugjerimet apo mendimet e tyre. Por, që të paraqiten se marrin pjesë këtë e dëgjojmë vetëm përmes mjeteve të "informacionit" të ashtuquajtura media.

6. Sa përdoren organizatat joqeveritare si trup këshillues në sferat në të cilat veprojnë?

Përmenda më lartë që ata përdoren për qëllime të caktuara dhe pastaj "zhduken".

7. A mendoni se organizatat joqeveritare janë të pavarura nga politika dhe kritike ndaj pushtetit? Ju lutem jepni shembuj!

OJQ-të mendoj që nuk janë të pavaruara nga politika dhe aspak nuk janë kritike ndaj pushtetit. Ato që kanë qenë kritike kanë përfunduar keq sa p.sh. ka pasur raste gjatë 25 viteve që shoqata të shndërrohet në parti politike dhe e kundërta partia politike maksimalisht të shfrytëzoj shoqatën. Këtë e kemi edhe më të freskët në zgjedhjet e fundit parlamentare kur shoqata të caktuara “humanitare” kanë ndarë ndihma e pas tyre kanë shkuar mercenarët për vota.

8. Në cilat sfera mendoni se organizatat joqeveritare kanë luajtur më shumë rol? Jepni disa shembuj!

Një numër i vogël i shoqatave më së shumeti kanë ndihmuar raste konkrete që pastaj përmes mediave të pompozohen që të marrin akcionin tjetër. OJQ-të me ndikim nga jasht kanë dhënë ndihma konkrete për rregullimin e rrugëve rajonale, ujësjellësve etj. edhe pse kemi raste të abuzimeve për të cilat Prokuroria as që do të dëgjoj.

9. Cilat janë arsyet e mundshme për mungesë efikasiteti të punës së organizatave joqeveritare?

Arsye kryesore për mungesë të efikasiteti e shoh në:

- inkuadrimin e njerëzve të kriminalizuar në prapaskenë të OJQ-ve,
- gatishmëria e subjekteve të caktuara për të flijuar për vlera morale,
- joprofesionalizmi dhe
- mbështetja reale e pushtetit.

Prof. Bahri Aliu
Drejtor i Medresesë – Dega e vajzave Tetovë

P.S.

Kërkesa nga kandidatja më erdh përmes emailit tim privat.

Pranova që t’iu përgjigjem mbase nuk ju njoh, por me qëllim që të keni sukses në disertacionin tuaj shpresoj se do të ngelni të kënaqura. Përshëndetje.